



**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**  
**01 Nr. 352/01-27477 /2018**  
**Dt. 26.09.2018**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010), nenit 12 dhe 17 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 1, pika (p), Neni 17 pika ”b”, Neni 55, pika “m” të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe kërkesës nr.ref. 120/IKMN/2018, të datës 22.01.2018 nga Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2018 pas diskutimit në pikën e 7 të rendit të ditës të Ndryshme, lidhur me rekomandimin e MAPL-së dhe MMPH-së për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimeve për shpalljen nën mbrojtje si monumente të natyrës nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “KOMPLEKSI I TRUNGJEVE” NË**  
**JABLLANICË TË GJAKOVËS NË KATEGORINË MONUMENT I NATYRËS**

**Neni 1**

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës “Kompleksi i trungjeve” në fshatin Jabllanicë” të Gjakovës në kategorinë monument natyre me karakter botanik (këtu e tutje: Monument i Natyrës).

2. Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej 7 ha 21 ari.

Kompleksi i trungjeve si monument i natyrës i mbrojtur i ka këto karakteristika dendrometrike:

Lartësia e trungut..... nga 17 deri në 27 m  
Perimetri i trungut ..... nga 2 deri në 4,5 m  
Diametri i kurorës..... nga 7 deri në 15 m  
Vjetërsia e trungut ..... mbi 300 vite<sup>1</sup>.

**Neni 2**

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur “Zabeli i Gojanit”, në Jabllanicë në parcelën 579-0, zona kadastrale Jabllanicë, nr. P-70705037-00579-0, me sipërfaqe 72.092 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pron publike.

**Neni 3**

1. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i kategorisë së III-të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

2. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- 2.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo frutave, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme natyrore,
- 2.3. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
- 2.4. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,
- 2.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- 2.6. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur

2.7. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

2.8. Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

3. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

3.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

#### Neni 4

1. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohe:

1.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,

1.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,

1.3. Ndërrimi i kulturës,

1.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të Natyrës.

2. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

#### Neni 5

1. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, është përgjegjëse Komuna e Gjakovës.

2. Personi fizik apo juridik është përgjegjës që:

2.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,

2.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat monumentit të natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

2.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të monumentit të natyrës, në pajtim me legjislacionin në fuqi për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

#### Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

#### Neni 7

vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

#### Neni 8

**Vendimi iu dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës,

z. Anton Shala